

INFRAKOS KTHEN NË MENAXHIM OBJEKTIN E STACIONIT TË HEKURUDHËS NË DRENAS DY VITE PARA SKADIMIT TË KONTRATËS

Autoritetet e Infracos-it kthejnë në menaxhim objektin e stacionit të Hekurudhës në Drenas i cili ishte i dhënë me koncension për 15 vite kompanisë NTSH Valentina.

Koncesionarja zj. Mihane Bekteshi, njëherit edhe pronare e kompanisë NTSH Valentina me pëlqim dhe vullnet të saj pa asnjë lloj kompensimi i dorëzon autoriteteve të Infracos-it objektin dy vite para kohës së skadimit të kontratës.



Pranim dorëzimi i objektit është bërë me anë të marrëveshjes ndërmjet dy palëve me qëllim të pajtueshmërisë që koncesionarja do ta dorëzojë objektin në gjendje të paraparë sipas kontratës së koncesionit si dhe të ofrojë dëshmi që i ka kryer të gjitha obligimet tatimore duke i përfshi edhe shërbimet tjera publike.

Infracos mirëpret dorëzimin e objektit para skadimit të kontratës i cili tashmë do të shërbejë për personelin e Infracosit, operatoreve transportues hekurudhor dhe qytetareve të Drenasit.



Tashmë, Infrakos do ta ketë me të lehtë operimin dhe menaxhimin e këtij stacioni duke pas parasysh që hapësira do të jetë e mjaftueshme në mbarëvajtjen e punëve dhe detyrave të personelit, operatoreve transportues hekurudhor si dhe udhëtarët do ta kenë komoditetin në dhomat e pritjes të cilët përdorin trenin për udhëtim.

Infrakos është e përkushtuar që të krijoj shërbime profesionale dhe të sigurta për operoret transportues hekurudhor dhe klientëve të saj.